

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses D. ( A.) Gj., nga Peja, të cilën e përfaqëson me autorizim avokatura "N." , A. N., avokat nga Peja, kundër të paditurës K. e S. " S." me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson K. P., nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, AC.nr. 890/2013 datë 20.7.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 2.11.2016, merr këtë

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, AC.nr. 890/2013 datë 20.7.2016 .

#### A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, AC.nr. 890/2013 datë 20.7.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komonale, Pejë C. nr. 838/2011 datë 27.12.2012, në pjesën II të dispozitivit , për frikën e përjetuar, vuajtjet e përjetuara për shëmtim , në pjesën V të dispozitivit dhe pjesën VI të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës. Me pjesën II të dispozitivit pjesërisht është aprovuar ankesa e të autorizuarit të paditëses dhe është ndryshuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komonale Pejë, C.nr. 838/2011 datë 27.12.2012, në pjesën e kërkesëpadiisë për kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet fizike dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe pika IV e dispozitivit të të njëjtit aktgjykim në pjesën e kërkesëpadiisë për kompensimin e dëmit material, për shpenzime rreth kujdesit dhe ndihmës së personit të huaj, ushqimit të përforcuar dhe dëmtimit të veshmbathjes, ashtu që kjo pjesë është gjykuar si në vijim: është detyruar e paditura që paditëses në emër të kompensimit të

dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datë 06.12.2011, nga baza e auto përgjegjësisë t'ia paguajë shumat si në vijim: në emër të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 8.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 27.550 €, në emër të dëmit material: për shpenzime rreth kujdesit dhe ndihmës së personit të huaj shumën prej 600 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50 €, për dëmtim të veshmbathjes shumën prej 100 €. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses për kompensim të dëmit jo material, në emër të dhimbjeve fizike dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, mbi shumat e gjykuara është refuzuar si e pabazuar. Me pjesën III të dispozitivit është ndryshuar pika 6 e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale Pejë lidhur me kamatën e gjykuar ashtu që në këtë pjesë është gjykuar si në vijim: është detyruar e paditura që paditëses të gjitha shumat e gjykuara në emër të shpërblimit të dëmit jo material dhe material, t'ia paguajë me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 27.12.2012 e gjer në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe tejkalimit të kërkesëpadisë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, ashtu që t'i ndryshoi shumat e aprovuara nga gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar shumën totale prej 28.000 €, ndërsa shumat përtej kësaj të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 6.12.2011, vozitësi Sh. V., duke drejtuar automjetin e markës VW'' Kombi 253'' me targë të regjistrimit ..., të siguruar te e paditura, ka shkaktuar fatkeqësinë e komunikacionit, ashtu që shpejtësinë e vozitjes nuk ia ka përshtatur kushteve të rrugës dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacion ashtu që në vendkalim për këmbësor godet paditësen e cila ishte duke kaluar rrugën , me ç'rast paditësja pëson lëndime të rënda trupore, që si pasojë tek paditësja kanë shkaktuar dhimbje fizike, frikë, shëmtim trupor,

zvogëlim të aktivitetit jetësor 55%, i janë shkaktuar shpenzime për kujdesin dhe ndihmën e huaj, ushqim të përforcuar dhe dëmtimin e veshmbathjes.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material është shpërblim real dhe objektiv, ndërsa ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për dëmin material, më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar. Ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka caktuar shumat si në dispozitivin e aktgjykimit, për frikën e pësuar dhe vuajtjet e përjetuara për shëmtim, ndërsa ka pranuar pretendimin e të paditurës lidhur me shumën e caktuar për zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe pretendimin e paditëses për dhimbjet fizike, ashtu që ka gjykuar shumat si në dispozitivin e atij aktgjykimi. Lidhur me dëmin material ka aprovuar ankesën e paditëses, ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar dhe ka gjykuar shumat e cekura si në pjesën II të dispozitivit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses pjesërisht është e bazuar. Gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur kanë gjykuar shumat për kompensim të cilat duhet t'i paguajë e paditura paditëses, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material, ngase, shumat e gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga ekspertët Dr. F. Sh.- kirurg i përgjithshëm, Dr. M. H. – psikiatër dhe Dr. S. U. - ortoped , në bazë të intensitetit të dhimbjeve fizike, intensitetit të frikës së pësuar, shëmtimit trupor dhe në bazë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Vërtetimi i shpërblimit (satisfaksioni) për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me të mos të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditëses e cila ka pësuar lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë në momentin e shkakimit të aksidentit, zvogëlimin e aftësisë së përhershme jetësore për 55% , zvogëlimin e aktivitetit për punë, humbja e një veshke nën moshën 20 vjeçare, pasoja për të ardhmen ku paditësja duhet të jetë nën kontroll të rregullt mjekësor për përcjelljen e funksionimit të veshkës së djathtë si dhe kontroll të trombociteve të cilat rriten pas splenektomisë, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës, e duke pasur parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit paditëses nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë për dëmin material është i drejt dhe i bazuar në dispozitën ligjore nga neni 195 par.1. të LMD –ës, për të cilën ajo Gjykatë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për një gjykim të

drejt e të bazuar në ligj, të cilat arsye i mbështet edhe kjo Gjykatë, pa pasur nevojë që të njëjtat të përsëriten edhe njëherë, andaj edhe pretendimet e cekura në revizion në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e të paditurës se paditëses i ka ofruar shumën prej 28.000 € me qëllim të zgjedhjes së kontestit, dhe pretendimin se shumata e gjykuara mbi shumën e propozuar janë të pabazuara, por e njëjta nuk ndikoi që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 2.11.2016, Rev.nr.257/2016

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku